

mortore të Shyhretes janë rivarrosur në varrezat e vendlindjes në Junik.

**Burimet:** deklarata N.D, FDH-17906; deklarata NN, FDH-12201; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 183, FDH-23816.

---

### **Ajmone (Imer Kurmehaj) Balaj**

(1940, shqiptare nga Carrabregu i Epërm/ Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/ Deçani, amvise, nëntë fëmijë)

Në datën **29.05.1998**, kur forcat serbe filluan të bombardonin **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg**, Ajmone Balaj gjendej në shtëpinë e vet së bashku me vajzën Timen dhe vajzën e kunatit, Ajeten. Nga ora 11:00, ato tentuan që të largoheshin nga zona e luftimeve. Kur arritën në *Mëhallën Dobraj*, Ajmonen e qëlluan në këmbën e djathtë me pushkë snajperi. Bashkëfshatarët i ndihmuan që të vazhdonte rrugën. Murat Dautaj e ka çuar me qerren e kuajve në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić. Nga ky fshat, më pas, e dërguan te mjeku në Isniq/Istinić. Por, ajo ndërroi jetë në rrugë e sipër. Në datën 30.05.1998, e kanë varrosur në varrezat e fshatit Irzniq/Rznić, ku edhe sot gjendet varri i saj.

**Burimet:** deklarata A.B, FDH-17896; deklarata NN, FDH-12201; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 183, FDH-23816; deklarata A.N, FDH-12188.

---

### **Ajshe (Fakë Krasniqi) Loshaj**

(1926, shqiptare nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, katër fëmijë)

### **Teuta (Rasim) Loshaj**

(21.06.1977, shqiptare nga Carrabregu i Epërm/ Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, amvise)

Forcat serbe kanë filluar të bombardojnë **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg** më **29.05.1998**. Teuta, së bashku me të ëmën Hatmonen dhe gjyshen Ajshe, u strehua në bodrumin e kushëririt Xhaferit. Nga ora 16:00, forcat serbe arritën te shtëpia ku gjendeshin ato. Teuta doli me të ëmën nga shtëpia me qëllim që të braktisnin

fshatin, ndërsa në bodrum kanë mbetur gjyshja Ajshe dhe babai i Teutës. Ishin duke vrapuar përmes bahçes së komshiut, Avdyl Tahirajt, kur u vunë re nga forcat serbe. Serbët kanë shtënë ndaj tyre duke e plagosur dhe rrëzuar në tokë të ëmën e Teutes. Duke tentuar që t'i ndihmonte të ëmës që të ngrihej në këmbë, Teuta u kthye dhe, në atë çast, e kanë qëlluar me plumb në gjoks. Ka dhënë shpirt në vend. Gjatë natës, të afërmit e kanë marrë trupin e saj dhe e kanë çuar në Prekollukë/Prekoluka, ku edhe e kanë varrosur në varrezat e atjeshme. Nëna e Teutës u dërgua së pari në spital në Irzniq/Rznić, pastaj në Pejë/Peć dhe, së fundi, në Beograd. Babai i Teutës ka shkuar në Shqipëri, ndërkaq gjyshja Ajshe konsiderohej e zhdukur. Në muajin shtator të vitit 1998, pas kthimit në fshat, familjarët e kanë gjetur trupin e karbonizuar të Ajshe. Pas përfundimit të luftës, më 15.10.2000, familja i ka varrosur mbetjet mortore të Teutës dhe Ajshe në varrezat e Carrabregut të Epërm/Gornji Crnobreg.

**Burimet:** deklarata H.L, FDH-17900; deklarata A.N, FDH-12188; deklarata NN, FDH-12201; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 183, 207, FDH-23816; deklarata V.N, FDH-12144; deklarata N.N, FDH-12143.

---

### **Shaqir (Kingj) Dobraj**

(13.08.1906, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/ Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, pensionist, pesë fëmijë)

Para pensionimit, Shaqiri i moshuar punonte në depon e një hoteli në Deçan/Deçane. Ai u vra më **29.05.1998**, kur forcat serbe e ndërmoren sulmin ndaj **Carrabregut të Epërm/Gornji Crnobreg** me anë të granatimeve. U qëllua me armë zjarri përpara shtëpisë së vetë, përderisa kthehej nga kushëriri Avni Dobraj, shtëpia e të cilit ishte afro 10-15 metra larg nga shtëpia e Shaqirit. Trupi i Shaqirit ka mbetur në rrugë. Vetëm më 1.07.1998, disa pjesëtarë të UÇK-së, në mesin e të cilëve edhe kushëriri i Shaqirit, Hakiu, ia dolën që të depërtonin në fshat. Ata e varrosën Shaqirin në bahçen e Bajram Bozhdarajt. Në muajin shtator të vitit 1998, familjarët